

VENDIM
Nr. 193, datë 4.3.2015

**PËR SHPALLJEN E ZONËS EKONOMIKE, ME STATUSIN “ZONË E LIRË”, NË
SPITALLË 2, DURRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 9789, datë 19.7.2007, “Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e zonës ekonomike, me statusin “Zonë e lirë”, të territorit me sipërfaqe 22 ha, pjesë e zonës kadastrale nr. 8517, në përbërje të së cilës janë parcelat me nr. pasurie 148/6 dhe nr. 149/1, në Spitalle 2, Durrës.

2. Shtrirja dhe kufizimet e kësaj zone përcaktohen në hartën treguese, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Lloji i veprimtarisë, që do të zhvillohet në këtë zonë, është:

- veprimtari prodhuese, përpunimi dhe agropërpunim;
- veprimtari tregtare, import-eksport;
- shërbime dhe magazinim mallrash;
- veprimtari ndihmëse.

4. Periudha e funksionimit të zonës është 35 vjet.


5. Procedura e përzgjedhjes së zhvilluesit të zonës së lirë të bëhet në zbatim të rregullave dhe procedurave konkurruese, të përcaktuara në ligjin nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar.

6. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletore Zyrtare

KRYEMINISTRI
Edi Rama

RILEVIM TOPOGRAFIK
i prones se "Ferra"Sh.p.k.(Spitalle,Durres)
Shkalla 1 : 2500



SHENIME TEKNIKE:
-MATJET U KRYEN ME GPS "TOPCON POWER PLUS"
-SAKTESIA NE MATJEN E PIKAVE DETAJE ESHTJE +/- 9MM
-PERMASAT NE KETE MATERIAL SHPREHIN
GJATESINE NE METRA NGA ANA E JASHTHE E MURIT
(PRA MURI ESHTJE PERFSHIRE NE SIPERFAQEN E PRONES)
-KANALI NUK ESHTJE PERFSHIRE NE 2 SIPERFAQET
-SIPERFAQJA E KANALIT ESHTJE 4080 M2

POROSITES : "FERRA"SH.P.K.		
	PUNOI: STUDIO TOPOGRAFIKE "GEOMATICA"SH.P.K.	
	NUMRI I LICENCES 4509/3 DATE 02.04.2012	KY MATERIAL U PREGATIT ME DATE 25.01.2015
DREJTUES TEKNIK: ING.DIPL.JAK SJALI	CEL:+355 69 20 73392 CEL:+355 69 40 70070 E-MAIL: jakusali@yahoo.com WEB: www.geomatica.al	